



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

KRYETARI I BASHKISË KORÇË

KËRKESË

PËR

**MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR TË BASHKISË KORÇË**


Kryetari i Bashkisë Korçë,
mbështetur në:

Ligjin nr. 8652 dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 32, pika k dhe n; Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 5, pika 1.3/a dhe neni 12 pika 2/a, të VKM 671, datë 29.07.2015 "Rregullore e Planifikimit të Territorit", neni 58, pika 1/b,

kërkon:

1. Miratimin e nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë
2. Pjesë integrale e kësaj kërkesë është Dokumenti i Nismës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

Për D.P.K.ZH.T.


Urb. Zhaneta LUBONJA

Për Drejtorinë Juridike


Anxhela DISHNICA

SOTIRAO FILO


KRYETAR I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Dokumenti i nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

Përmbajtja

Hyrje	2
Analiza e qëllimit dhe nevojës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor	2
Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare	3
Kufijtë e territorit të Bashkisë Korçë	3
Plani i veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor	5
Strategjia e miratimit të Planit të Përgjithshëm vendor	13
Lista e dokumenteve përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor	13
Ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojë PPV-në.....	17
Forumi Këshillimor i Planit të Përgjithshëm Vendor (FKPPV)	18
Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike	18
Buxheti për hartimin dhe miratimin e PPV-së	19
Pezullimi i Zhvillimit në Territorin e Bashkisë Korçë.....	19

Hyrje

Ky dokument harohet bazuar në Vendimin nr. 1 të Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, pika 1, në të cilën përcaktohet: “Të gjitha autoritetet vendore të fillojnë procedurat për hartimin e planeve të përgjithshme vendore për territorin vendor përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi”

Autoriteti përgjegjës për hartimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë Korçë. Me urdhër të tij, në Bashkinë Korçë është ngritur grupi i punës për hartimin e PPV-së. Grupi i punës ka për detyrë zbatimin e planit të veprimeve për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor. Ai përbëhet nga specialistë të Bashkisë dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët mund të jenë vendës apo të huaj. Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), si Autoritet Kombëtar i Planifikimit, do të kryejë procedurat e prokurimit publik për të përzgjedhur ekspertët vendas apo të huaj, të cilët do të ndihmojnë Bashkisë Korçë në hartimin e PPV-së. Një përfaqësues i AKPT-së do të ndihmojë në zbatimin e procedurave për hartimin e PPV-së, sipas parashikimeve të ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe rregullores “Për planifikimin e territorit”. Ndjekja dhe monitorimi i procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë midis MZHU, AKPT dhe Bashkisë Korçë.

Analiza e qëllimit dhe nevojës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor

Këshilli i Kombëtar i Territorit, në datën 30 Korrik 2015, vendosi që, të gjitha autoritetet vendore të fillojnë procedurat për hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për territorin përkatës. Ky vendim merr shkas nga nevoja për pajisjen me plane të përgjithshme vendore të unifikuara në kuadrin e ndarjes së re administrativo – territoriale si dhe nga nevoja për drejtimin e zhvillimit të territorit në ndërkohë.

Bazuar në këtë vendim, Bashkia Korçë fillon procedurat duke ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, në zbatim të Ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe “Rregullores së Planifikimit”.

Niveli i dytë i planifikimit të territorit në Republikën e Shqipërisë është planifikimi në nivel vendor, i cili kryhet përmes dokumenteve të planifikimit, midis të cilëve dhe Plani i Përgjithshëm Vendor. Qëllimi i Planit të Përgjithshëm Vendor është zbatimi i standardeve të unifikuara të planifikimit, të cilat janë nivelet optimale të cilësisë, që përdoren si norma e referenca gjatë procesit të vazhdueshëm të planifikimit dhe të cilat mundësojnë një zhvillim të qëndrueshëm brenda kufijve të territorit të tij.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) burojnë nga neni 20 i Ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe janë si më poshtë:

- a) balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor;

- b) krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit;
- c) drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme;
- ç) rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- d) planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- dh) rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitetet publike, sipas ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”;
- e) rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

Plani i Përgjithshëm Vendor zbatohet nëpërmjet planeve sektoriale, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit.

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

Vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 20.12.2012, “*Përcaktimi i projektit të Gazsjellësit Trans – Adriatik (TAP) si çështje e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit*”, i cili në pikën 2 vendos “Shpalljen “zonë kombëtare” të korridorit me gjerësi 500m të Projektit TAP [...]”

Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “*Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike*”

Vendimi nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, “*Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015*”. Në këtë listë përfshihet edhe “Banesa e Vangjush Mios”, monument kulture i kategorisë së I-rë.

Kufijtë e territorit të Bashkisë Korçë

Kufijtë e territorit të Bashkisë Korçë jepen në hartën e mëposhtme:



Me miratimin e Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Korçë përbëhet nga tetë njësi administrative. Në territorin e saj tashmë përfshihet jo vetëm territori i qytetit të Korçës, por dhe territori i 63 fshatrave. Në mënyrë analitike, përbërja e Bashkisë Korçë jepet në tabelën e mëposhtme:

Bashkia	Njësiti administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Korçë	Korçë	Qyteti Korçë
	Qendër Bulgarec	Fshatrat: Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht (13)
	Voskop	Fshatrat: Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë Lart, Goskovë Poshtë, Damjanec (7)
	Voskopojë	Fshatrat: Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadh, Lavdar (5)
	Lekas	Fshatrat: Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë (12)
	Vithkuq	Fshatrat: Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë (13)
	Mollaj	Fshatrat: Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë (5)
	Drenovë	Fshatrat: Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë (8)

Plani i veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor

FAZA 1	FAZA PËRGATITORE	
	Ngritja e grupit të punës	Urdhër i Kryetarit të Bashkisë Korçë. Grupi i punës përbëhet nga Konsulentë (të huaj ose/dhe vendas) dhe nga Specialistë të Bashkisë.
		Brenda 10 ditëve nga lëshimi i Urdhërit të Kryetarit Botimi i Urdhërit në Regjistrin e Territorit
	Vendimi për marrjen e nismës	Vendimi i Kryetarit të Bashkisë Korçë për Marrjen e Nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor
	Miratimi i nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë	Brenda 10 ditëve pas marrjes së Vendimit <ol style="list-style-type: none"> 1. Botimi i Vendimit për marrjen e nismës dhe dokumentacionit shoqërues, në Regjistrin e Territorit dhe njëkohësisht në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë 2. Kërkesë drejtuar Këshillit të Bashkisë për miratimin e nismës
		Brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës Këshilli Bashkiak miraton nismën
		Brenda 10 ditëve nga miratimi i nismës Botimi i Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e nismës dhe dokumentacionit shoqërues, në Regjistrin e Territorit dhe njëkohësisht në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë Pas botimit në regjistër Vendimi hyn në fuqi
	Takim informues	Takim për të informuar qytetarët për marrjen e nismës për hartimin e PPV-së të Bashkisë Korçë
	Përzgjedhja e Konsulencës për hartimin e PPV-së	Procedurat e prokurimit publik për përzgjedhjen e Konsulencës (MZHU)
		Njoftimi i Kryetarit të Bashkisë mbi Konsulencën e përzgjedhur (nga MZHU)
		Brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit nga MZHU Botimi i Njoftimit në Regjistrin e Territorit
	Përcaktimi i përfaqësuesit të AKPT-së	Njoftimi i Kryetarit të Bashkisë mbi përfaqësuesin e AKPT-së, i cili do të ndihmojë në zbatimin e procedurave për hartimin e PPV-së sipas parashikimeve të Ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe “Rregullores së Planifikimit”. (nga AKPT)
		Brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit nga AKPT Botimi i Njoftimit në Regjistrin e Territorit
Ngritja e Forumit Këshillimor të Planit të Përgjithshëm Vendor	Forumi ngrihet me angazhimin e posaçëm të Kryetarit të Bashkisë dhe mund të institucionalizohet prej tij me anë të një marrëveshjeje. Detyrat dhe mënyra e funksionimit të FKPPV-së përcaktohen në marrëveshjen përkatëse.	
	Brenda 10 ditëve , në rast institucionalizimi të FKPPV-së Botimi i Marrëveshjes në Regjistrin e Territorit	
Njohja e grupit të punës me Studimet, Politikat dhe Planet ekzistuese	Personat fizikë apo juridikë, që ndodhen në zonën e planifikimit ose që kanë informacion apo të dhëna për të duhet, kur u kërkohet dhe për aq sa kanë mundësi të bëjnë një gjë të tillë, t’i japin autoritetit përkatës të planifikimit ose çdo personi të autorizuar, pa kundërshtim, informacionin që	

		disponojnë, i cili mund të nevojitet gjatë procesit të hartimit të dokumentit të planifikimit.
	Inventari i Bashkisë Korçë	Personat fizikë apo juridikë, që ndodhen në zonën e planifikimit ose që kanë informacion apo të dhëna për të duhet, kur u kërkohet dhe për aq sa kanë mundësi të bëjnë një gjë të tillë, t'i japin autoritetit përkatës të planifikimit ose çdo personi të autorizuar, pa kundërshpërbllim, informacionin që disponojnë, i cili mund të nevojitet gjatë procesit të hartimit të dokumentit të planifikimit.
FAZA 2	FAZA E ANALIZËS DHE E VLERËSIMEVE	
	Bashkëpunimi	Gjatë të gjithë fazës së analizës dhe vlerësimeve do të ketë një bashkëpunim të ngushtë midis grupit të punës dhe institucioneve përgjegjëse në të gjitha nivelet, për marrjen e të dhënave dhe informacioneve të nevojshme për këtë fazë.
	Analiza e Planeve, Strategjive, Politikave, normave dhe standardeve ekzistuese	Rishikimi i inventarit të Bashkisë
		Analiza e dokumenteve të planifikimit të Bashkisë Korçë në fuqi
	Skanimi i territorit dhe vlerësimi	Dokumentimi dhe rishikimi i Planit Kombëtar të Territorit dhe Planit Sektorial, normave dhe standardeve ekzistuese
		Pasqyrimi i përgjithshëm dhe analiza mjedisore
		Përdorimi ekzistues i tokës; Aktivitetet dhe ndikimet
		Analiza e të dhënave demografike
		Aspektet social – ekonomike
		Analiza e infrastrukturës ekzistuese
	Përgatitja e bazës së të dhënave territoriale të integruara në platformën GIS	Çështje të tokës dhe të pronësisë
		Paraqitja në harta e situatës aktuale (në shkallë 1:5000 deri 1:25000 dhe sipas legjislacionit në fuqi)
	Përgatitja e bazës së të dhënave territoriale të integruara në platformën GIS	Inventari i Bashkisë, i kryer gjatë fazës përgatitore do të analizohet dhe konvertohet në formatin kombëtar të regjistrit.
		Bazuar në legjislacionin e planifikimit, do të hartohet një strukturë e bazës së të dhënave dhe një plan veprimi për mbledhjen e të dhënave dhe mirëmbajtjen e tyre.
FAZA 3	STRATEGJIA TERRITORIALE	
	Bashkëpunimi	Gjatë të gjithë fazës së hartimit të strategjisë territoriale do të ketë një bashkëpunim të ngushtë të grupit të punës, të përbërë nga konsulentit, specialistët e bashkisë dhe përfaqësuesi i AKPT-së.
	Bashkërendimi	Bashkërendimi horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit dhe bashkërendimi vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit janë përgjegjësi funksionale e AKPT-së , në përputhje me nenin 9 të ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Produkt i këtij bashkërendimi është akti i përputhshmërisë ose rekomandimet e AKPT-së, të cilat duhet të pasqyrohen në projektaktin e planifikimit
	Projektakti i Strategjisë Territoriale shoqëruar me studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe	Dorëzohet zyrtarisht në Bashkinë Korçë
		Brenda 10 ditëve nga dorëzimi i projektaktit Botimi në regjistrin e projektaktit Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.

	ndikimit në mjedis	Sipas procedurave të përcaktuara në marrëveshjen përkatëse, do realizohet takimi dhe do të merren vërejtjet dhe propozimet e FKPPV-së
Këshillim dhe takim me publikun	Vërejtje dhe propozime të Forumit Këshillimor të Planit	Brenda 1 dite hartohet përmbledhja e vërejtjeve dhe propozimeve Pas 1 dite nga takimi i FKPPV-së Botimi në regjistër i përmbledhjes së vërejtjeve dhe propozimeve Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.
	Këshillim dhe takim me publikun	Njoftimi i publikut nëpërmjet: 1. Regjistrit 2. 2 gazetave me qarkullim të madh 3. Organeve të tjera të medias Në njoftim përcaktohet vendi, data dhe ora e takimit Data e takimit duhet të caktohet të paktën 30 ditë nga data e njoftimit Në periudhën kohore (të paktën 30 ditore) midis njoftimit dhe organizimit të takimit, palët e interesuara kanë të drejtë të kenë akses në materialet dhe informacionet që lidhen me dokumentin e planifikimit përfshirë përmbledhjen e procesit të bashkërendimit dhe në vërejtjet, propozimet e përfundimet e arritura gjatë procesit të bashkërendimit. Aksesit i tyre sigurohet, paraprakisht, në kohë të mjaftueshme e në mënyrë efektive nëpërmjet regjistrit dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.
	Këshillim dhe takim me publikun	Brenda 1 dite hartohet përmbledhja e vërejtjeve dhe propozimeve Pas 1 dite nga takimi Botimi në regjistër i përmbledhjes së vërejtjeve dhe propozimeve Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.
	Këshillim dhe takim me publikun	Brenda 30 ditëve nga takimi, Kryetari i Bashkisë Korçë vendos: 1. Rishikimin e projektaktit (në rast se dalin çështje thelbësore të përmbajtjes) 2. Arsyet e argumentuara për moskryerjen e rishikimit Përcjell dokumentacionin e plotë të projektaktit për shqyrtim në AKPT, të shoqëruar me arsyet e argumentuara për moskryerjen e rishikimit
	Këshillim dhe takim me publikun	Brenda 10 ditëve pas marrjes së vendimit nga Kryetari i Bashkisë: Botimi në regjistër i dokumentacionit të plotë të projektaktit, i shoqëruar me Vendimin përkatës në lidhje me Moskryerjen e Rishikimit Botimi në regjistër i kërkesës për shqyrtim të dokumentacionit, drejtuar AKPT-së

		Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.
	Rishikimi i projektaktit	Rishikimi i projektaktit kryhet për çështje thelbësore të përmbajtjes së tij Në rast rishikimi të projektaktit përsëritet e njëjta procedurë nga bashkëpunimi deri në Këshillimi dhe takimi me publikun
	Deklaratë mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis	Procedura do të ndiqet nga Bashkia Korçë para miratimit të projektaktit në Këshillin e Bashkisë
	Dokumenti i Strategjisë Territoriale shoqëruar me Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis (AKPT)	Brenda 15 ditëve nga marrja e dokumentacionit, AKPT kryhen shqyrtimin e tij dhe harton raportin e vlerësimit teknik për projektaktin
		Pas 15 ditëve nga marrja e dokumentacionit, AKPT: 1. Jep aktin e përputhshmërisë , ose 2. Jep rekomandimet , të cilat duhet të pasqyrohen në projektakt 3. Boton në regjistër raportin e vlerësimit teknik dhe aktin e përputhshmërisë ose rekomandimet
		Në rast të moszbatimit të afateve të mësipërme, Bashkia Korçë njofton Agjencinë për mosrespektimin e afatit dhe lëshon deklaratën e përputhshmërisë në heshtje .
		Në rast se AKPT jep rekomandime , kryhet rishikimi/përmirësimi i dokumentacionit sipas procedurës së mëposhtme
		Brenda 15 ditëve nga botimi në regjistër nga AKPT-ja, i raportit të vlerësimit teknik dhe rekomandimeve , vërejtjet dhe sugjerimet duhet të reflektohen në dokumentacion nga autoriteti përgjegjës, i cili harton dhe raportin e ndryshimeve
		Pas 15 ditëve nga botimi në regjistër nga AKPT-ja, i raportit të vlerësimit teknik dhe rekomandimeve, Bashkia Korçë 1. Riboton dokumentacionin e rishikuar/përmirësuar shoqëruar me raportin e ndryshimeve 2. Ridërgon në AKPT dokumentacionin e rishikuar/përmirësuar shoqëruar me raportin e ndryshimeve
		Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga AKPT, përsëritet sa herë ka rishikim/ përmirësim nga autoriteti përgjegjës për hartimin e projektaktit
	Miratimi i Strategjisë Territoriale shoqëruar me Deklaratën mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis, nga Këshilli i Bashkisë	Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtimin dhe miratimin e projektaktit, drejtuar Këshillit Bashkiak Brenda 15 ditëve nga kërkesa për shqyrtim dhe miratim, Këshilli Bashkiak vendos për: Miratimin e dokumentit Rishikimin e projektaktit, së bashku me arsyet e mosmiratimit Në përfundim të rishikimit, projektakti i dokumentit të planifikimit i ridërgohet për miratim Këshillit të Bashkisë. Brenda 10 ditëve nga miratimi i dokumentit

		Botimi në regjistër i dokumentit të planifikimit, së bashku me Vendimin e Këshillit Bashkiak
	<p>Miratimi i Strategjisë Territoriale</p> <p>shoqëruar me</p> <p>Deklaratën mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis, nga KKT</p>	Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentacionit, drejtuar KKT
		Brenda 15 ditëve nga kërkesa për shqyrtim dhe miratim, KKT vendos për: Miratimin e dokumentit Rishikimin e dokumentit, së bashku me arsyet e mosmiratimit
		Në rast rishikimi të projektaktit, atëherë kryhet bashkëndimi me AKPT-në në lidhje me procesin e rishikimit
		Në përfundim të rishikimit, projektakti i dokumentit të planifikimit i ridërgohet për miratim KKT-së
		Brenda 15 ditëve nga miratimi i dokumentit <ol style="list-style-type: none"> Botimi në regjistër i Strategjisë Territoriale dhe Deklaratës mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis së bashku me Vendimin e KKT-së për miratimin e tyre KKT i dërgon Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe Bashkisë Korçë një kopje të dokumentit të planifikimit të miratuar, së bashku me vendimin e miratimit të tij.
	Brenda 10 ditëve nga marrja e dokumentacionit nga KKT-ja, Bashkia Korçë: Boton në regjistër vendimin e KKT-së dhe dokumentet shoqëruese të tij	
	Deklarata e përgjegjesisë profesionale nga hartuesit	Hartuesit e dokumentit të planifikimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë përgjegjësie, ku dëshmojnë se dokumenti i dorëzuar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit është në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit e të zhvillimit, si edhe me legjislacionet e tjera që ndikojnë në planifikimin e territorit. Hartuesit e dokumentit të planifikimit nuk mbajnë përgjegjësi për ndërhyrjet, ndryshimet dhe rishikimet që autoriteti përgjegjës për planifikimin i bën dokumentit të planifikimit, por vetëm për dokumentacionin e hartuar e nënshkruar prej tyre, dorëzuar zyrtarisht pranë autoritetit përgjegjës.
FAZA 4	PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE RREGULLORJA E ZBATIMIT TË PPV	
	Bashkëpunimi	Gjatë të gjithë fazës së hartimit të Planit të Zhvillimit të Territorit dhe Rregullores së Zbatimit të PPV-së, do të ketë një bashkëpunim të ngushtë të grupit të punës, të përbërë nga konsulenti, specialistët e bashkisë dhe përfaqësuesi i AKPT-së.
	Bashkëndimi	Bashkëndimi horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit dhe bashkëndimi vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit janë përgjegjësi funksionale e AKPT-së , në përputhje me nenin 9 të ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Produkt i këtij bashkëndimi është akti i përputhshmërisë ose rekomandimet e AKPT-së, të cilat duhet të pasqyrohen në projektaktin e planifikimit

	<p>Projektakti i Planit të Zhvillimit të Territorit dhe i Rregullores së Zbatimit të PPV-së shoqëruar me Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis</p>	<p>Dorëzohet zyrtarisht në Bashkinë Korçë</p> <p>Brenda 10 ditëve nga dorëzimi i projektaktit Botimi në regjistër i projektaktit Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.</p>
	<p>Vërejtje dhe propozime të Forumit Këshillimor të Planit</p>	<p>Sipas procedurave të përcaktuara në marrëveshjen përkatëse, do të merren vërejtjet dhe propozimet e FKPPV-së</p> <p>Brenda 1 dite hartohet përmbledhja e vërejtjeve dhe propozimeve</p> <p>Pas 1 dite nga takimi i FKPPV-së Botimi në regjistër i përmbledhjes së vërejtjeve dhe propozimeve Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.</p>
	<p>Këshillim dhe takim me publikun</p>	<p>Njoftimi i publikut nëpërmjet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Regjistrin 2. 2 gazetave me qarkullim të madh 3. Organeve të tjera të medias <p>Në njoftim përcaktohet vendi, data dhe ora e takimit Data e takimit duhet të caktohet të paktën 30 ditë nga data e njoftimit</p> <p>Në periudhën kohore (të paktën 30 ditore) midis njoftimit dhe organizimit të takimit, palët e interesuara kanë të drejtë të kenë akses në materialet dhe informacionet që lidhen me dokumentin e planifikimit përfshirë përmbledhjen e procesit të bashkërendimit dhe në vërejtjet, propozimet e përfundimet e arritura gjatë procesit të bashkërendimit. Aksesin e tyre sigurohet, paraprakisht, në kohë të mjaftueshme e në mënyrë efektive nëpërmjet regjistrin dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.</p> <p>Brenda 1 dite hartohet përmbledhja e vërejtjeve dhe propozimeve</p> <p>Pas 1 dite nga takimi Botimi në regjistër i përmbledhjes së vërejtjeve dhe propozimeve Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.</p> <p>Brenda 30 ditëve nga takimi, Kryetari i Bashkisë Korçë vendos:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rishikimin e projektaktit (në rast se dalin çështje thelbësore të përmbajtjes) 2. Arsyet e argumentuara për moskryerjen e rishikimit <p>Përcjell dokumentacionin e plotë të projektaktit për shqyrtim në AKPT, të shoqëruar me arsyet e argumentuara për moskryerjen e rishikimit</p> <p>Brenda 10 ditëve pas marrjes së vendimit nga Kryetari i Bashkisë:</p>

		<p>Botimi në regjistër i dokumentacionit të plotë të projektaktit, i shoqëruar me Vendimin përkatës në lidhje me Moskryerjen e Rishikimit</p> <p>Botimi në regjistër i kërkesës për shqyrtim të dokumentacionit, drejtuar AKPT-së</p> <p>Njoftimi nëpërmjet një ose disa mjeteve tradicionale të informimit.</p>	
Rishikimi i projektaktit		<p>Rishikimi i projektaktit kryhet për çështje thelbësore të përmbajtjes së tij</p> <p>Në rast rishikimi të projektaktit përsëritet e njëjta procedurë nga bashkëpunimi deri në Këshillimi dhe takimi me publikun</p>	
Deklaratë mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis		<p>Procedura do të ndiqet nga Bashkia Korçë para miratimit të projektaktit në Këshillin e Bashkisë</p>	
<p>Dokumenti i Planit të Zhvillimit të Territorit dhe i Rregullores së Zbatimit të PPV-së</p> <p>shoqëruar me</p> <p>Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis</p> <p>(AKPT)</p>		<p>Brenda 15 ditëve nga marrja e dokumentacionit, AKPT kryhen shqyrtimin e tij dhe harton raportin e vlerësimit teknik për projektaktin</p> <p>Pas 15 ditëve nga marrja e dokumentacionit, AKPT:</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Jep aktin e përputhshmërisë, ose 5. Jep rekomandimet, të cilat duhet të pasqyrohen në projektakt 6. Boton në regjistër raportin e vlerësimit teknik dhe aktin e përputhshmërisë ose rekomandimet <p>Në rast të moszbatimit të afateve të mësipërme, Bashkia Korçë njofton Agjencinë për mosrespektimin e afatit dhe lëshon deklaratën e përputhshmërisë në heshtje.</p> <p>Në rast se AKPT jep rekomandime, kryhet rishikimi/përmirësimi i dokumentacionit sipas procedurës së mëposhtme</p> <p>Brenda 15 ditëve nga botimi në regjistër nga AKPT-ja, i raportit të vlerësimit teknik dhe rekomandimeve, vërejtjet dhe sugjerimet duhet të reflektohen në dokumentacion nga autoriteti përgjegjës, i cili harton dhe raportin e ndryshimeve</p> <p>Pas 15 ditëve nga botimi në regjistër nga AKPT-ja, i raportit të vlerësimit teknik dhe rekomandimeve, Bashkia Korçë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Riboton dokumentacionin e rishikuar/përmirësuar shoqëruar me raportin e ndryshimeve <p>Ridërgon në AKPT dokumentacionin e rishikuar/përmirësuar shoqëruar me raportin e ndryshimeve</p> <p>Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga AKPT, përsëritet sa herë ka rishikim/ përmirësim nga autoriteti përgjegjës për hartimin e projektaktit</p>	
			<p>Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtimin dhe miratimin e projektaktit, drejtuar Këshillit Bashkiak</p> <p>Brenda 15 ditëve nga kërkesa për shqyrtim dhe miratim, Këshilli Bashkiak vendos për:</p> <p>Miratimin e dokumentit</p> <p>Rishikimin e projektaktit, së bashku me arsyet e mosmiratimit</p>
	Miratimi i Planit të Zhvillimit të Territorit dhe i Rregullores së Zbatimit të PPV-së		
	shoqëruar me		

	<p>Deklaratën mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis, nga Këshilli i Bashkisë</p>	<p>Në përfundim të rishikimit, projektakti i dokumentit të planifikimit i ridërgohet për miratim Këshillit të Bashkisë. Brenda 10 ditëve nga miratimi i dokumentit Botimi në regjistër i dokumentit të planifikimit, së bashku me Vendimin e Këshillit Bashkiak</p>
<p>Miratimi i Planit të Zhvillimit të Territorit dhe i Rregullores së Zbatimit të PPV-së shoqëruar me Deklaratën mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis, nga KKT</p>		<p>Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë për shqyrtimin dhe miratimin e dokumentacionit, drejtuar KKT Brenda 15 ditëve nga kërkesa për shqyrtim dhe miratim, KKT vendos për: Miratimin e dokumentit Rishikimin e dokumentit, së bashku me arsyet e mosmiratimit Në rast rishikimi të projektaktit, atëherë kryhet bashkëndimi me AKPT-në në lidhje me procesin e rishikimit Në përfundim të rishikimit, projektakti i dokumentit të planifikimit i ridërgohet për miratim KKT-së Brenda 15 ditëve nga miratimi i dokumentit 1. Botimi në regjistër i Planit të Zhvillimit të Territorit, Rregullores së Zbatimit të PPV-së dhe Deklaratës mjedisore për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis së bashku me Vendimin e KKT-së për miratimin e tyre KKT i dërgon Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe Bashkisë Korçë një kopje të dokumentit të planifikimit të miratuar, së bashku me vendimin e miratimit të tij.</p>
		<p>Brenda 10 ditëve nga marrja e dokumentacionit nga KKT-ja, Bashkia Korçë: Boton në regjistër vendimin e KKT-së dhe dokumentet shoqëruese të tij</p>
	<p>Deklarata e përgjegjesisë profesionale nga hartuesit</p>	<p>Hartuesit e dokumentit të planifikimit duhet të nënshkruajnë një deklaratë përgjegjësie, ku dëshmojnë se dokumenti i dorëzuar pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit është në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit e të zhvillimit, si edhe me legjislacionet e tjera që ndikojnë planifikimin e territorit. Hartuesit e dokumentit të planifikimit nuk mbajnë përgjegjësi për ndërhyrjet, ndryshimet dhe rishikimet që autoriteti përgjegjës për planifikimin i bën dokumentit të planifikimit, por vetëm për dokumentacionin e hartuar e nënshkruar prej tyre, dorëzuar zyrtarisht pranë autoritetit përgjegjës.</p>

Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 23 të ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, informon AKPT-në dhe palët e interesuara për ecurinë e procesit çdo muaj ose sipas një kalendari të dakordësuar dhe me Agjencinë, i cili lidhet me hartimin e pjesëve përbërëse të dokumentit të planifikimit. Informimi, i cili duhet të jetë një raport periodik i ecurisë së procesit, bëhet nëpërmjet regjistrit dhe një ose disa mjeteve tradicionale të informimit publik.

Takime të rregullta, sipas kërkesave dhe nevojave për konsultim, të grupit të ekspertëve me grupin e punës së Bashkisë Korçë në të gjitha fazat e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Bashkia Korçë do të sigurojë grupit të ekspertëve, nëpërmjet stafit dhe pajisjeve teknike në dispozicion të saj, mbështetjen e nevojshme gjatë gjithë procesit të hartimit të PPV-së.

Strategjia e miratimit të Planit të Përgjithshëm vendor

Miratimi i planit do të kryhet me dy ndalesa dhe nënkupton miratimin fillimisht të Strategjisë Territoriale të Zhvillimit të Bashkisë Korçë së bashku me Deklaratën mjedisore për Studimin e Vlerësimit të Ndikimit nga Zhvillimi dhe Ndikimit në Mjedis. Faza e dytë dhe i gjithë procesi përfundon me miratimin e Planit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë shoqëruar me Rregulloren e Zbatimit të tij së bashku me Deklaratën mjedisore përkatëse për studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis.

Lista e dokumenteve përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor

Dokumenti i PPV-së, do të hartohet për të gjithë territorin e Bashkisë Korçë, dhe bazohet në këtë përmbajtje:

1. Bazën e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të regjistrit të integruar të territorit;

2. Strategjinë Territoriale të Bashkisë Korçë, e cila përfshin: [FAZA 3]

a) dokumentin e analizës metabolike të territorit që i paraprin strategjisë territoriale, vizionin strategjik dhe objektivat e zhvillimit;

b) planin e veprimeve strategjike/prioritare, investimeve kapitale dhe projektet pilot të zhvillimit;

c) hartat që ilustrojnë strategjinë e zhvillimit të territorit në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000.

Strategjia territoriale përmban të paktën:

1. parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga PPK-ja, PKS-ja, PSNQ-ja, në fuqi apo proces hartimi, të cilat ndikojnë në territorin vendor;
2. analizën metabolike dhe vlerësimin e përgjithshëm të territorit të Bashkisë Korçë;
3. përcaktimin e territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
4. identifikimin e problematikave që rrjedhin nga analiza e mësipërme;
5. vizionin e zhvillimit të territorit të Bashkisë Korçë;
6. objektivat strategjike për zhvillimin e territorit të Bashkisë Korçë;
7. drejtimet për zhvillimin e territorit të Bashkisë Korçë në bazë të treguesve të sistemeve;

8. programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimit kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të Bashkisë Korçë dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjike;
9. planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore, burimet njerëzore dhe buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve;
10. hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të Bashkisë Korçë, drejtimit kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit, objektivat dhe fazat kohore të zbatimit të programeve e projekteve;
11. hartën e sistemeve ekzistuese së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem.

3. Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Korçë, që përfshin: [FAZA 4]

- a) dokumentin e analizës së thelluar të territorit që i paraprin planit të zhvillimit;
- b) propozimin me përcaktime territoriale në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor;
- c) hartat që shoqërojnë dhe pasqyrojnë përmbajtjen e secilit prej sistemeve më sipër, në shkallën që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000;
- ç) relacionin e propozimeve;
- d) vlerësimin ekonomik dhe financiar për zbatimin e PPV-së;
- dh) planin e veprimeve, investimeve dhe projekteve për zbatimin e PPV-së;
- e) treguesit për monitorimin e zbatimit të PPV-së.

Plani i zhvillimit të territorit përmban, të paktën:

3.1. planin e propozimeve territoriale

Plani i propozimeve territoriale përmban, të paktën:

- 1) ndarjen e territorit sipas pesë sistemeve;
- 2) zonimin sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës;
- 3) ndarjen e territorit në njësi;
- 4) pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave, përfshirë hapësirat publike dhe përcaktimin e kushteve teknike kryesore për realizimin e infrastrukturave;
- 5) zonat e mbrojtura të rëndësisë kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet;
- 6) përcaktimin e zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban;
- 7) tipologjitë e propozuara hapësinore;
- 8) përcaktimin e njësive, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-së;
- 9) shpërndarjen e popullsisë në territor sipas treguesve të parashikimit demografik dhe ekonomik, të specifikuar në nivel territori urban;
- 10) planin e strehimit, bazuar në nevojat e konstatuara, e tashmë dhe ato të projektuara, duke përcaktuar zonat/njësitë për dendësim, rigjenerim, rihvillimin, konservim, urbanizim nëse janë zona të reja dhe territoret për programe sociale të strehimit;

11) përcaktimin e zonave/njësive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit sipas ligjit, në rast se parashikohen të tilla.

3.2 planin e mbrojtjes së mjedisit

Plani i mbrojtjes së mjedisit, përmban:

- 1) parashikimet për mbrojtjen e peizazhit;
- 2) parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore;
- 3) parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra;
- 4) parashtrimin e dy varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar për sa u përket hotspotëve;
- 5) parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

3.3 planin e shërbimeve dhe infrastrukturave publike;

Plani i shërbimeve dhe infrastrukturave publike, përmban:

- 1) infrastrukturë publike të propozuar sipas pikës 11, të nenit 3 të ligjit;
- 2) konsiderata nga planet e niveleve të tjera, sipas ndikimit në territorin vendor;
- 3) tipologjinë, cilësinë, shpërndarjen në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukim, shëndetësi etj.) që propozohen.

3.4 planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së;

Planin e veprimeve për zbatimin e PPV-së, i cili përmban:

- 1) fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit, për zonat me prioritet zhvillimi, PDV-të, rrjetet kryesore të infrastrukturave publike dhe projektet pilot;
- 2) koston e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara të shoqëruara me planin e investimeve kapitale;
- 3) ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ në nivel vendor.

3.5 Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PPV-së.

3.6 Shtojcat I-II-III të PPV-së sipas formatit të rregullores.

Shtojcat e PPV-së, të cilat përmbajnë të gjitha dokumentet e përmendura për këtë qëllim, studimet ndihmëse që merren nga institucionet përgjegjëse për sektorë të caktuar, si dhe studime për qëllime të veçanta që ndërmerren nga vetë Bashkia Korçë.

4. Rregulloren e zbatimit të PPV-së. [FAZA 4]

Rregullorja e PPV-së përmban, të paktën:

4.1 Përkufizimet e termave të përdorur;

4.2 Shpjegimin e kodeve të përdorura për:

- a) kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
- b) sistemet;
- c) zonat;
- ç) njësitë;

d) kode të tjera sipas rastit.

4.3 Rregullat e përdorimit të tokës, të cilat përmbajnë, të paktën:

- a) kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës;
- b) aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës, sipas rastit;
- c) përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse.

4.4 Rregullat për çdo zonë dhe njësi që përmbajnë, të paktën:

- a) kushtet e zhvillimit sipas rregullores së zhvillimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara, sipas kategorive dhe nënkategorive të përdorimit të tokës;
- c) normat, treguesit dhe standardet e zbatueshme të planifikimit, sipas “Rregullores së Planifikimit”;
- ç) të drejtat dhe kufizimet ligjore, publike apo private, që rrjedhin nga përdorimi i treguesve të zhvillimit;
- d) listën e instrumenteve që mund të përdoren për të drejtuar zhvillimin sipas ligjit, përfshirë të drejtat dhe kufizimet ligjore që rrjedhin prej tyre.

4.5 Rregullat e nënndarjes dhe të bashkimit të parcelave në çdo njësi që përmbajnë, të paktën:

- a) kushtet për procesin e ndarjes dhe bashkimit;
- b) aksesin në infrastrukturë;
- c) afatet e nënndarjes dhe të zhvillimit, sipas rastit.

4.6 Rregullat e sistemit rrugor dhe të transportit që përmbajnë, të paktën:

- a) përcaktimin dhe përshkrimin e kategorive të rrjetit rrugor, në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
- b) kushte teknike dhe përmasat;
- c) parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit publik, në përputhje me legjislacionin e posaçëm;
- ç) përcaktimin e vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë dy anëve të trupave rrugore.

4.7 Rregullat e ruajtjes së mjedisit, peizazhit, burimeve natyrore, zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore që përfshijnë, të paktën:

- a) normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi;
- b) normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore, historike dhe mjedisore;
- c) përcaktimin e vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu);
- ç) rregulla arkitektonike dhe estetike, sipas rastit;
- d) rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.

Shënim: Autoritetet e planifikimit vendor gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe rregullores në zbatim të tij nuk duhet të shkelin kriteret minimale të treguesve të zhvillimit, përcaktuar në rregulloren (kombëtare) e zhvillimit, por në çdo rast në rregulloret e tyre vendore mund të përcaktojnë tregues zhvillimi që reflektojnë nevojat e territorit në administrim, të tilla si: diellëzimi, pozicioni gjeografik, kushtet klimaterike etj.

5. Studimin e vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe të ndikimit në mjedis.

Hartimi i studimit të vlerësimit të ndikimit nga zhvillimi dhe ndikimit në mjedis do të kryhet duke iu referuar legjisllacionit të posaçëm në fuqi, paralelisht me PPV.

Ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojë PPV-në

Grupi i punës do të përbëhet nga specialistë të Bashkisë dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme, të cilët mund të jenë vendës apo të huaj. Ministria e Zhvillimit Urban (MZHU), si Autoritet Kombëtar i Planifikimit, do të kryejë procedurat e prokurimit publik për të përzgjedhur ekspertët vendas apo të huaj, të cilët do të ndihmojnë Bashkisë Korçë në hartimin e PPV-së, bazuar dhe në vendimin e këshillit të ministrave nr. 670, datë 29.7.2014, si më poshtë:

VENDIM

Nr.670, datë 29.7.2015

PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR REALIZIMIN E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT PËR HARTIMIN E PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE DERI PËR 26 BASHKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurës së prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Fondi prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh për përbalimin e pjesshëm të shpenzimeve, për vitin 2015, për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban për vitin 2015.
3. Pjesa tjetër e fondeve prej 530 000 000 (pesëqind e tridhjetë milionë) lekësh të përballohet nga buxheti i shtetit për vitin 2016. Kjo vlerë të parashikohet në buxhetin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitin 2016.
4. Ministria e Zhvillimit Urban të fillojë procedurat e prokurimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe, përpara lidhjes së kontratës për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve, të marrë miratimin e njësisë të qeverisjes vendore dhe të lidhë aktmarrëveshjen përkatëse. Lidhja e aktmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe bashkisë për caktimin e kushteve

dhe të drejtave e tëdetyrimeve midis palëve është kusht për lidhjen e kontratës për hartimin e planeve vendore nga kjo ministri.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe bashkitë, sipas listës bashkëlidhur vendimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E BASHKIVE

- | | |
|----------------|------------------|
| 1) Dibër | 14) Konispol |
| 2) Durrës | 15) Krujë |
| 3) Gjirokastrë | 16) Kurbin |
| 4) Korçë | 17) Librazhd |
| 5) Kukës | 18) Përrenjas |
| 6) Lezhë | 19) Pogradec |
| 7) Shkodër | 20) Poliçan |
| 8) Tiranë | 21) Rrogozhinë |
| 9) Vlorë | 22) Sarandë |
| 10) Cërrik | 23) Shijak |
| 11) Divjakë | 24) Skrapar |
| 12) Himarë | 25) Urë-vajguore |
| 13) Kavajë | 26) Vorë |

Forumi Këshillimor i Planit të Përgjithshëm Vendor (FKPPV)

Kryetari i Bashkisë Korçë, me angazhimin e tij të posaçëm, do të krijojë Forumin Këshillimor të Planit të Përgjithshëm Vendor. Ky forum do të përbëhet nga përfaqësues të akademisë, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. Qëllimi i tij është konsultimi lidhur me çështjet dhe zhvillimet kryesore gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike

Takimet këshilluese zhvillohen me grupet e interesit dhe ekspertë të fushës, si edhe, në rast se janë ngritur pranë njësive vendore, me forumet këshillimore vendore (FKV). Takimet këshillimore kanë në fokus tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga grupet e specializuara ose që preken drejtpërdrejt nga dokumenti i planifikimit.

“Këshillimi dhe takimi publik” është akt konsultimi me publikun ku tentohet tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij. Autoriteti përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit organizon, të paktën një takim

këshillues dhe një takim informues për publikun me marrjen e nismës për hartimin e dokumentit, përpara çdo vendimmarrjeje planifikuese dhe i përsërit ato sipas nevojës për informimin e plotë të palëve të interesuara dhe zgjidhjen e konflikteve ose edhe atëherë kur kërkohet nga Forumi Këshillimor Vendor.

Këshillimi me FKPPV-në dhe takimi publik mund të organizohen veçmas ose të bashkërendohen, në varësi të kalendarit të autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit. Sidoqoftë, përmbledhjet e vërejtjeve dhe/apo propozimeve të secilit takim duhet të hartohen të veçanta. Takimi **publik** zhvillohet me një publik të gjerë, i cili përfaqëson të gjitha shtresat dhe profilet e shoqërisë që jeton apo punon brenda territorit për të cilin hartohet dokumenti i planifikimit.

“**Bashkërendimi**” është ndërveprimi mes autoriteteve kombëtare të planifikimit, mes tyre dhe autoriteteve vendore apo mes autoriteteve vendore të planifikimit, gjatë procesit të planifikimit në nivel vendor, me synim harmonizimin e trajtimit të çështjeve të rëndësishme kombëtare e vendore, të fushave e sektorëve të ndryshëm në planifikimin e territorit. Bashkërendimi horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit dhe bashkërendimi vertikal ndërmjet autoriteteve kombëtare dhe atyre vendore të planifikimit janë përgjegjësi funksionale e AKPT-së, në përputhje me nenin 9 të ligjit “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”. Bashkërendimi kryhet përpara çdo vendimmarrjeje dhe pasi është kryer këshillimi publik.

Buxheti për hartimin dhe miratimin e PPV-së

Shpenzimet e nevojshme për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, do të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe fondet e Bashkisë Korçë. Kontributi financiar i bashkisë lidhet me angazhimin e stafit të saj në procesin e grumbullimit të informacionit dhe organizimin e aktiviteteve publike dhe detyrimeve specifike ligjore si, tarifat e VSM-së.

Pezullimi i Zhvillimit në Territorin e Bashkisë Korçë

Bashkia Korçë, me ndërmarrjen e kësaj nisme, parashikon pezullimin e zhvillimit në territorin e saj gjatë procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 29.7.2015. Gjatë këtij procesi, zhvillimi në territorin e Bashkisë Korçë do të kryhet në përputhje me Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”.

VENDIM

Nr. 672, datë 29.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT TË

MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, miratuar me vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, neni 45, “Dispozita kalimtare” ndryshohet, si më poshtë vijon:

Neni 45

Deri në miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për territoret administrative të bashkive:

a)kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm për zhvillime të propozuara në zona të territorit vendor, për të cilat janë miratuar dokumentet e planifikimit të territorit, sipas hartës bashkëlidhur, me përjashtim të zonave me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe brezit bregdetar, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.


b)për të gjitha zonat e tjera, që nukpërfshihen në shkronjën “a”, të këtij neni, kërkesat për leje ndërtimi do të merren në shqyrtim nga autoritetet përgjegjëse vetëm sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit.

c)për objektet mbi 6 kate, sipas shkronjave“a” dhe “b”, të këtij neni, leja e ndërtimit jepet nga Këshilli Kombëtar i Territorit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Harta me territoret vendore që kanë dokumenta planifikimi të miratuara



Drejtorja e Planifikimit, Kontrollit dhe

Zhvillimit të Territorit

DREJTORE

ZHANETA LUBONJA

Korçë, më 09.11.2015